

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"AGROPOINT" SH.P.K

Ky statut perpilohet nga:

Paola Sula, e bija e Dashnor Sula dhe Elida Sula, e datelindjes 12/06/1995, lindur ne Elbasan dhe banuese ne Tirane, me adrese Rr. Irfan Tershana Nr. 12, e pajisur me leternjoftimin nr.032168864 dhe Nr. Personal J55612082N madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

E quajtur me poshte ortakut themelues, me vullnetin e saj te lire dhe ne perputhje me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe me aktet e tjera te legjislacionit shqiptar qe trajtojne keto çeshtje, krijon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, si vijon:

KREU I
NENI 1
FORMA

Ortakut i mesiperm krijon nje Shoqeri me Pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Shqiperi dhe me dispozitat e ketij Statuti.

NENI 2
EMRI I SHOQERISE

Emri i shoqerise do te jete **"AGROPOINT" SH.P.K**

NENI 3
SELIA E SHOQERISE

Selia qendrore e shoqerise do te jete ne qytetin e Peqinit me adrese: Ish Reparti Ushtarak nr.5012, Njesia Administrative Karine, Zona kadastrale 2093. Numer pasurie 670 dhe 671, Peqin. Shoqeria ka te drejte qe me vendim te asamblese se ortakeve mund te hape dege, zyra, filiale ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise.

NENI 4
KOHEZGJATJA

Shoqeria do te kete kohezgjatje te papercaktuar.

NENI 5

PS

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria do te kete per objekt veprimtarie:

Agro Turizem, bar restorant, hoteleri (bujtine), prodhimin dhe tregtimin e fruta perimeve, mbareshtim dhe rritje blegtorie dhe shpendeve te llojeve te ndryshem. Prodhimi i veres, rakise, vajit te ullirit, prodhimin e kompostove recelit nga llojet e ndryshme te frutave. Prodhimi i produkteve nga perpunimi i mishit, zarzavateve, qumeshtit dhe te tjera produkte dhe nenprodukte ne funksion te agriturizmit.

Shoqeria do te ushtroje cdo aktivitet tregtar qe eshte eshte ne funksion dhe ne mbeshtetje te objektit te veprimtarise; Agro Turizem.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR , KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR DHE TRANSFERIMI

NENI 6

Kapitali themeltar shoqerise eshte 1,000,000 (nje milion) Leke i ndare ne kuota si me poshte:

1. Paola Sula, zoteruese e 1 kuote qe perfaqeson 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

NENI 7

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqerise i takon ortakut themelues ne masen 100 %.

NENI 8

TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Kuotat e kapitalit themeltar te shoqerise mund te transferohen me ane aktesh juridike mes te gjalleve dhe me trashegimi. Transferimi i kuotave te kapitalit te shoqerise nuk i nenshtrohet asnje lloj kufizimi, ne qofte se ndodh ne rast vdekjeje.

Ne rast se shoqeria do te zoterohet nga disa ortake dhe njeri nga ortaket do te deshiroje te transferoje nje pjese apo te gjithë kuoten qe ai zoteron ne shoqeri, atehere ai duhet ti drejtohet me nje kerkese shoqerise, me ane te se ciles ti bej te ditur sasine e kuotes, cmimin (e vleresuar nga nje ekspert) dhe personin te cilit do tia transferoje. Shoqeria (ortaket) eshte i detyruar qe



brenda nje afati tre mujor ti ktheje pergjigje nese deshiron ti bleje kuotat me te njetat kushte apo jo. Ne rast se brenda afatit shoqeria (ortaket) nuk kthen pergjigje atehere tranferimi konsiderohet si i miratuar dhe ortaku eshte i lire te kryej tranferimin sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

KREU III

MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 9

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Asambleja e ortakeve organizon, drejton dhe kontrollon gjithe aktivitetin e shoqerise. Ortaket perballojne humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se kontributit te secilit.

NENI 10

DREJTIMI SHOQERISE

Organi me i larte drejtues i shoqerise do te jete asambleja e ortakeve. Asambleja e ortakeve mblidhet si rregull dy here ne vit, si dhe sa here qe gjykohet e aresyeshme. Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjesen e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

NENI 11

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleja e ortakeve vendos per keto ceshtje:

- Emeron administratorin e shoqerise.
- Emeron ekspertet kontabel.
- Miraton bilancin vjetor.
- Vendos per shperndarjen e dividendit te shoqerise.
- Ben ndryshime ne statut.
- Vendos per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.
- Ne rast te shperndarjes se shoqerise cakton likujdatorin dhe e shkarkon ate kur perfundon likujdimi.
- Si dhe per cdo ceshtje qe gjykon te aresyeshme
- Vendimet e asamblese nenshkruhen nga ortaket

NENI 12

ADMINISTRATORI

Shoqeria do te administrohet nga Paola Sula per nje afat 3 (tre) vjecar.

PS

NENI 13

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori i shoqerise emerohet nga asambleja e ortakeve dhe pergjigjet per zbatimin e vendimeve te asamblese se ortakeve

Administratori ka keto kompetenca :

- Te beje drejtimin e shoqerise .
- Te perpiloje dhe nenshkruaje kontratat dhe aktet juridike qe kane te bejne me veprimtarine e shoqerise;
- Te hapi llogari rrjedhese bankare prane bankave te nivelit te dyte, shqiptare ose te huaja.
- Te perfaqesoje shoqerine ne mardhenie me te tretet.
- Te emeruje nenpunes te rangjeve te ndryshme per veprime te vecanta teknike ose per nje kategori te caktuar veprimesh;
- Te beje gjithcka tjeter qe konsiderojne te dobishme dhe qe eshte ne perputhje me formen e ketij Statuti si dhe me legjislacionin shqiptar ne fuqi, per te arritur qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.

KREUI V

LIBRAT E LLOGARISE, BILANCI, FITIMI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

NENI 14

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacinit kontabel qe kerkon legjislacioni ne fuqi edhe keto libra:

- 1- Libri i ortakeve, ne te cilin shenohen emrat e plote te Ortakeve dhe kuotat qe secili ka ne kapitalin e themelimit.
- 2- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te asamblese.
- 3- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te Admimstratoreve.
- 4- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit sindikal.

NENI 15

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, EKSPERTI KONTABEL

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar do te filloje pas regjistrimit te shoqerise

DS.

si person juridik dhe do te perfundoje me 31 Dhjetor te atij viti. Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e veçanta te hartuara nga admimstratori miratohen nga asambleja e ortakeve. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

KREU V
NENI 16
AKTIVITETI FINANCIAR

Ne çdo mbyllje te çdo viti financiar administratori ben inventarin dhe llogarine vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin, si dhe hartohet nje raport me shkrim Bilancit i bashkengjiten:

- a. Nje situacion mbi garancite e dhena nga shoqeria,
- b. Nje situacion mbi sigurimet e bera nga shoqeria,

Raporti i administratoreve perfshi gjendjen gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtarite e mundshme qe jane zhvilluar nga data e mbylljes se vitit financiar deri ne ditën qe eshte hartuar ky raport.

Dokumentet vihen ne dispozicion te eksperteve kontabel te autorizuar, te pakten nje muaj para mbledhjes se asamblese.

NENI 17

Fitime neto te shoqerise do te konsiderohen fitimet qe rezultojne pas zbritjes nga te ardhurat e te gjitha shpenzimeve qe kane lidhje me aktivitetin e shoqerise, detyrimet fiskale, shoqerore, demet, amortizimet, etj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te veçanta financimi.

Perberja, shuma e pergjithshme, burimet per krijimin e fondit rezerve, perdorimi dhe rregullmi i çdo fondi te veçante caktohet nga asambleja e ortakeve ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Ne perputhje me ligjin nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar lihet menjane nje shume me vlere 1/20 e cila destinohet per krijimin e nje fondi "rezerve e domosdoshme".

NENI 18
PRISHJA E SHOQERISE

Shoqeria priset per arsye te parashikuara ne ligj. Shoqeria priset perpara afatit me vendim te Asamblese Ortakeve .



NENI 19

Rastet e pavlefshmerise se shoqerise ose te nje akti qe ndryshon statutin si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqerise behet ne perputhje me dispozitat e ligjit.

NENI 20

Kur shoqeria prishet ajo kalon ne likujdim dhe ne kete rast emertimit te shoqerise i shtohet shenimi "Shoqeri ne likujdim e siper". Shoqeria edhe gjate procesit te likujdimit vazhdon si person juridik deri ne perfundimin e procesit te likujdimit. Prishja e shoqerise eshte me pasoje ndaj te treteve vetem pas publikimit te prishjes ne regjistrin tregtar.

NENI 21

Per te perfunduar procesin e likuidimit, Asambleja e ortakeve emeron nje ose disa persona si likujdues te cilet perfaqesojne shoqerise. Likuiduesi perpilon bilancin financiar likujdon tek te tretet detyrimet e shoqerise, shet aktivet e shoqerise dhe ndan tepricat ne dispozicion.

NENI 22

Ne perfundim te mbylljes se likujdimit, ortaket thirren qe te vendosin per bilancin financiar perfundimtar, per aktin e rregullshmerise, per admimstrimin e tij nga ana e likujduesit dhe per heqjen e mandatit te likuiduesit, si dhe per t'u evidencuar mbyllja e likuidimit. Dokumentat e mesiperme miratohen nga Asambleja e Ortakeve .

NENI 23

Kur shoqeria likujdohet pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, u kthehen pronareve. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise dhe fondet fillestare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena pasi te jene likujduar kreditoret.

NENI 24

DISPOZITA TE FUNDIT

Shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes qe i nevojiten per te ushtruar veprimtarine e saj. Punesimi behet sipas kushteve te percaktuara ne legjislacionin e punes se Republikes se Shqiperise, si dhe rregullave te vena ne kontraten e vecante te punesimit qe lidhet midis punedhenesit e

Te gjitha punonjesit. Te gjitha problemet qe do te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private te kesaj shoqerie do te zgjidhen sipas rregullave te percaktuara ne statutin dhe legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Kur mosmarreveshjet nuk zgjidhen ne mirekuptim kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 25

Ky statut firmoset me vullnetin e lire te ortakut themelues.

09/12 /2021

THEMELUESI

Paolo Sula

